

Shërbimet që morën pjesë në program morën raportin e tyre individual të kompanisë në të cilin performanca e tyre në disa fusha krahasohet me shërbimet e tjera në grup dhe me performancën mesatare të shërbimeve jashtë vendit si referencë, treguesit financiarë, ekonomikë dhe teknikë të shoqërive ku u sigurohen krahasime me kompani me performanca më të mira, si dhe identifikohen zonat me përmirësime relativisht më të mëdha, boshllëqet dhe pengesat. Përveç kësaj, takimet regjionale të punës dhe diskutimet ndihmuan njëri tjetrin për të shkëmbyer njohuri dhe praktika të mira të punës, iniciativa të reja, dhe ekspertiza profesionale mbrenda përmbrnda SHUK.

## HUB-i SHQIPËFOLËS SHQIPËRI & KOSOVË

Edhe këtë vit SHUKALB dhe SHUKOS janë bashkuar të përkrahur nga IAWD dhe BB, ashtu sikurse në ciklet e mëparshme, për ta ofruar programin Benchmarking për shoqëritë ujësjellës kanalizime në Shqipëri dhe në Kosovë.

Qëllimi kryesor i programit është angazhimi i shoqërive UK në përdorimin e Benchmarking jo vetëm si mjet për monitorimin e performancës, por mbi të gjitha si një mjet për përmirësimin e saj, nëpërmjet analizimit të treguesve të performancës të ofruar nga platforma Data Camp në kuadër të D-Leap Akademi. Gjithashtu, vetë shoqëritë do të kenë mundësi të krahasohen me vetveten nëpër vite për nevoja të mbrendshme të menaxhmentit dhe akterëve vendimarrës, munden të krahasohen me shoqëri të ngjashme në rajon dhe më gjerë dhe të mësojnë nga praktikat më të mira të gjithsecilit.

Përvec përfitimeve të mësipërme për shoqëritë UK, nëpërmjet workshopeve kombëtare dhe rajonale, shkëmbimit të njohurive ndërkolegiale si dhe pjesëmarrjes në konferenca rajonale, programi do t'i shërbejë dhe rritjes së kapaciteteve profesionale të përfaqësuesve të shoqërive për të përmirësuar performancën e SHUK pjesëmarrës në këtë program.

HUB-i shqipëfolës për Shqipëri dhe Kosovë ofron përdorimin e platformes Data Camp **pa pagesë** vetëm për Shoqëritë UK të regjistruara në HUB-in shqipëfolës e që dëshirojnë të marrin pjesë në program në kuadër të D-Leap Akademi-Sistemit Informativ . SHUK duhet të procedojnë me regjistrimin duke ndjekur hapat e shpjeguar më poshtë, si dhe të kryejnë pagesën e regjistrimit prej 1,000 EUR për vit për shërbimet logjistike dhe organizative.

Më poshtë do të gjeni informacione të rëndësishme në lidhje me angazhimin tuaj në program.

### **Koordinimi i Programit:**

Koordinimi i Programit për të dy vendet do të bëhet nga:

*Znj. Nadire Bejtullahu Vitija, Menaxhere për Trajnime dhe ngritje profesionale, SHUKOS*

*Z. Avni Dervishi, Ekspert i jashtëm, SHUKALB*

### **Platforma e regjistrimit dhe analizimit të të dhënave:**

Platforma që do të përdoret për hedhjen e të dhënave, llogaritjen e variablave dhe treguesve kyc të performancës, është platforma e UBP Data Camp e mirëmbajtur nga IAWD/ D-Leap Akademi) e cila do të jetë në dispozicion në gjuhën shqipe me hapësirën individuale të çdo të regjistruari.

### **Regjistrimi:**

Për tu bërë pjesë e këtij programi, ju lutem plotësoni formularin e regjistrimit bashkangjitur dhe dërgojeni në adresën e e-mail-it [training@shukalb.al](mailto:training@shukalb.al) dhe [nadire.vitija@shukos.org](mailto:nadire.vitija@shukos.org).

### **Tarifa e regjistrimit:**

Tarifa e regjistrimit në program është 1,000 EUR për shoqëri. Tarifa duhet paguar në momentin e regjistrimit. Tarifa, së bashku me mbështetjen financiare të programit nga IAWD shkon për të mbuluar kosto pjesëmarrje të dy pjesëtarëve të stafit nga secila shoqëri UK në trajnime, takime rajonale, takime kombëtare, si dhe konferenca të sektorit në rajon.

**Raporti final** Të gjitha të dhënat disponohen në platformen UBP-Data Camp e cila gjeneron raportin standard individual dhe raporte specifike sipas kërkesës suaj.

### **Person kontakti:**

Nadire Vitija, Menaxhere për Trajnime dhe Zhvillim Profesional, Koorditore e HUB-it për Shqipërinë dhe Kosovën.